IKTK
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

GJURMA MUJORE

Shtator 2026

29 Shtatori – Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore

Dea e Butrintit kthehet në shtëpi!

Tirana Architecture Week TAW26 - Dita e 5-të

Bashkëpunim institucional për ruajtjen e trashëgimisë bektashiane

Restaurim, Teqeja e Koshtanit, Memaliaj

Plani i Konservimit dhe Gërmimeve Arkeologjike, Amfiteatri antik i Durrësit

Qesarati - mijëra vite histori nën tokë

Shqipëri - Greqi, bashkëpunim për rikthimin e objekteve të Butrintit

Programi Kombëtar për Rijetëzimin e Kullave

Trashëgimia arkeologjike shqiptare në finalen e "Palmyra Award"

Një etapë e re për Parkun Arkeologjik Bylis–Klos

Botimi nr. 09

IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.


29 Shtatori – Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore

Në të gjithë vendin, 29 Shtatori u shënua përmes një sërë aktivitetesh që sollën trashëgiminë kulturore më pranë komuniteteve dhe brezit të ri.

Nga sitet arkeologjike dhe monumentet e kulturës, te muzetë dhe hapësirat historike, aktivitetet e zhvilluara përfshinë ekspozita, vizita, ture interpretuese, orë mësimore pranë monumenteve dhe nisma ndërgjegjësuese. Përmes tyre, historia dhe vlerat e trashëgimisë u bënë pjesë e drejtpërdrejtë e përvojës së qytetarëve dhe vizitorëve.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua edukimit dhe përfshirjes së brezit të ri, duke e kthyer trashëgiminë në një hapësirë njohjeje, interpretimi dhe pjesëmarrjeje. Në të njëjtën kohë, aktivitetet sollën në vëmendje rëndësinë e ruajtjes së monumenteve, siteve arkeologjike dhe kontekstit të tyre, si dhe nevojën për kujdes të vazhdueshëm ndaj tyre.

29 Shtatori na kujton se trashëgimia kulturore nuk është vetëm një dëshmi e së kaluarës, por një vlerë që kërkon vëmendje, përkujdesje dhe transmetim të vazhdueshëm.
Nga njëri skaj i vendit në tjetrin, kjo ditë u bë një moment i përbashkët për ta njohur, përjetuar dhe vlerësuar trashëgiminë tonë.





IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.















IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Dea e Butrintit kthehet në shtëpi!

Pas një rrugëtimi nga qyteti antik drejt Romës dhe më pas në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë, një prej veprave më të çmuara të trashëgimisë sonë arkeologjike rikthehet në vendin ku u zbulua.

Rikthimi i Deas pasuron rrëfimin e Butrintit dhe u mundëson vizitorëve të shohin nga afër një dëshmi të jashtëzakonshme të historisë, artit dhe trashëgimisë sonë të përbashkët europiane.

Me mbi 200 mijë vizitorë gjatë 8-mujorit të parë të vitit 2026, Butrinti po forcon rolin e tij si një prej destinacioneve kryesore të turizmit kulturor në Shqipëri, një vend ku trashëgimia nuk mbetet vetëm dëshmi e së shkuarës, por krijon dije, mundësi dhe zhvillim për të ardhmen.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.













IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Tirana Architecture Week TAW26 - Dita e 5-të

Në Universitetin POLIS u përmbyll workshop-i “Architecture, memory and digital heritage: HBIM to VR strategies for the conservation of Gjirokastra”.

Dita e pestë iu kushtua prezantimeve finale të studentëve, të ndjekura dhe vlerësuara nga ekspertët e IKTK-së.

Workshop-i bashkoi akademinë, ekspertizën dhe teknologjinë, duke përdorur HBIM dhe VR për të eksploruar qasje të reja në dokumentimin, interpretimin dhe konservimin e trashëgimisë së Gjirokastrës.

IKTK vijon të mbështesë përdorimin e teknologjive digjitale si mjete bashkëkohore për dokumentimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.















IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Bashkëpunim institucional për ruajtjen e trashëgimisë bektashiane

Në ambientet e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane u zhvillua një takim ndërmjet përfaqësuesve të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, H.T. Baba Mondi.

Në fokus të takimit ishte bashkëpunimi institucional për ruajtjen, konservimin dhe restaurimin e pasurive kulturore të trashëgimisë bektashiane, me vëmendje të veçantë te "Vendi i Mirë Ballëm Sulltan (Guva)", pranë Teqesë së Vjetër, në Ballenjë, Martanesh, si dhe Teqeja në fshatin Peshk.

Gjatë diskutimit u trajtuan gjendja aktuale e këtyre objekteve, problematikat e evidentuara dhe mundësitë për ndërhyrje, duke synuar përmirësimin e aksesit dhe sigurisë, menaxhimin e ujërave dhe ruajtjen e vlerave autentike të monumenteve.

IKTK dhe Kryegjyshata Botërore Bektashiane do të vijojnë koordinimin dhe bashkëpunimin për mbrojtjen dhe përcjelljen e kësaj trashëgimie të çmuar kulturore te brezat e ardhshëm.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Restaurim, Teqeja e Koshtanit, Memaliaj

Teqeja e Koshtanit në Memaliaj po i nënshtrohet punimeve të restaurimit dhe konservimit, me synim ruajtjen e vlerave arkitektonike dhe historike të këtij Monumenti Kulture të Kategorisë I.
Përtej vlerave të saj si dëshmi e traditës bektashiane, teqeja mbart edhe një histori të rëndësishme për arsimin shqip. Në vitin 1908, në ambientet e saj u hap shkolla e parë shqipe në krahinën e Tepelenës.
Ndërhyrja e sotme synon të ndalojë proceset e degradimit dhe të ruajë autenticitetin e monumentit, duke i dhënë mundësi kësaj dëshmie të rëndësishme të historisë dhe kulturës së zonës të vijojë të jetë pjesë e jetës së komunitetit dhe të përcillet te brezat që vijnë.













IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Shqipëri - Greqi, bashkëpunim për rikthimin e objekteve të Butrintit

Komunikimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional sjell gjithmonë rezultate konkrete në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Një delegacion me ekspertë të MTKS, IKRTK, IKTK dhe BMF BUTRINT i shoqëruar nga përfaqësues të Ambasadës shqiptare, zhvilloi një vizitë pune në Muzeun Arkeologjik Kombëtar, Athinë në kuadër të procedurave për kthimin në Shqipëri të dy objekteve arkeologjike me origjinë nga Parku Kombëtar i Butrintit.

Vizita u realizua falë bashkëpunimit të mirë institucional shqiptaro-grek, duke u mundësuar ekspertëve dhe arkeologëve shqiptarë të njihen nga afër me objektet dhe të shkëmbejnë informacion teknik e profesional me kolegët grekë, në funksion të vijimit të procedurave dhe përmbylljes së procesit të kthimit.

Ky bashkëpunim dëshmon rëndësinë e dialogut dhe të angazhimit të përbashkët për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, si dhe për forcimin e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë në luftën kundër trafikimit dhe tregtisë së paligjshme të pasurive kulturore.

I shprehim mirënjohje autoriteteve dhe ekspertëve grekë për bashkëpunimin dhe gatishmërinë e treguar gjatë këtij procesi.





IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.


Programi Kombëtar për Rijetëzimin e Kullave

Tjetër lajm i mirë për trashëgiminë dhe zhvillimin e Veriut të Shqipërisë!

Së bashku me GIZ dhe ASHK po finalizojmë Programin Kombëtar për Rijetëzimin e Kullave, me synimin që brenda vitit 2027 të kalojmë nga evidentimi dhe projektimi në investime konkrete.

* 697 raste pronësie të trajtuara në Dibër, Shkodër, Lezhë dhe Kukës;
* 28 projekte konceptuale restaurimi, hartuar me Fakultetin e Arkitekturës të UPT-së;
* 64 kulla me status Monument Kulture në fokus të prioritizimit.

Kullat do të restaurohen dhe rijetëzohen me funksione të reja si bujtina, agroturizme, muze dhe qendra mikpritjeje, duke ruajtur trashëgiminë tonë e duke krijuar mundësi të reja për ekonominë dhe turizmin lokal.










IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Programi Kombëtar për Rijetëzimin e Kullave

Varri monumental i zbuluar në Strikçan të Bulqizës, në kuadër të një projekti të drejtuar nga Instituti i Arkeologjisë, është përzgjedhur mes pesë finalistëve për çmimin ndërkombëtar "Palmyra" dhe çmimin "Special" të publikut në Borsa Mediterranea del Turismo Archeologico (BMTA).
Mauzoleu i periudhës romake, që daton në shekujt III–IV, përfaqëson një zbulim të veçantë për arkeologjinë shqiptare dhe është i pari i këtij lloji i evidentuar në Shqipëri. Brenda tij janë zbuluar enë qelqi, objekte prej kocke dhe tekstile të endura me fije ari, duke ofruar të dhëna të reja mbi praktikat funerare dhe jetën në këtë territor gjatë periudhës romake.

Në finalen e "Palmyra Award", zbulimi shqiptar prezantohet përkrah gjetjeve arkeologjike nga Pompeii, Vulci, Taposiris Magna dhe Herakleia e Latmos, duke sjellë në vëmendje një tjetër dëshmi të rëndësishme të pasurisë arkeologjike të Shqipërisë.





IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Një etapë e re për Parkun Arkeologjik Bylis–Klos

Ka nisur një etapë e re e zhvillimit të Parkut Arkeologjik Bylis–Klos, mbështetur nga Bashkimi Europian dhe zbatuar nga AICS, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit.
Projekti përfshin krijimin e një Qendre të re Multifunksionale për Vizitorët, me hapësira muzeale, kërkimi dhe konservimi, si dhe ndërhyrje për konservimin e monumenteve të parkut.
Puna në terren ka nisur tashmë, duke ndërthurur kërkimin arkeologjik me konservimin dhe interpretimin e pasurisë së sitit. Një komponent i rëndësishëm i projektit lidhet edhe me komunitetin lokal, përmes mbështetjes së guidave vendase dhe krijimit të mundësive të reja për përfshirjen e komunitetit në zhvillimin e turizmit kulturor.

Një hap i ri për njohjen, ruajtjen dhe përjetimin e Bylisit, duke lidhur pasurinë arkeologjike me komunitetin dhe vizitorët.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Plani i Konservimit dhe Gërmimeve Arkeologjike, Amfiteatri antik i Durrësit

Në 60-vjetorin e zbulimit, Amfiteatri Antik i Durrësit vijon rrugëtimin e tij në një etapë të re të ruajtjes, studimit dhe interpretimit.
Ka nisur zbatimi i Planit të Konservimit dhe Gërmimeve Arkeologjike, investim i Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, ndërsa vijojnë kërkimet në kuadër të projektit italo-shqiptar "Durrësi Mesjetar – Amfiteatri", i cili prej vitit 2018 po sjell të dhëna të reja mbi historinë dhe zhvillimin e monumentit.

Krahas kërkimit shkencor dhe punës për konservimin e tij, Amfiteatri vijon të jetë një nga pikat më të vizituara të trashëgimisë kulturore. Vetëm gjatë periudhës Janar–Gusht 2026, monumenti u vizitua nga 28,823 persona, rreth 16,3% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.
Gjashtë dekada pas zbulimit, puna vazhdon: për ta njohur më thellë, për ta ruajtur me kujdes dhe për t'ia përcjellë vlerat brezave që vijnë.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Qesarati - mijëra vite histori nën tokë

Në Qesarat të Tepelenës, gërmimet arkeologjike po sjellin në dritë gjurmë të një historie që shtrihet në mijëra vite.
Në kuadër të projektit "Arkeologji e peizazhit në zonën Memaliaj–Tepelenë dhe rrethinat 2026", arkeologët shqiptarë dhe italianë kanë zbuluar gjurmë të një kompleksi rezidencial romak, me ambiente të pasura që dëshmojnë mënyrën e jetesës në këtë zonë gjatë antikitetit. Gjashtë dysheme mozaiku, mes tyre një me figurën e Erosit, si dhe fragmente suvaje murale të pikturuara, i shtohen dëshmive që po ndihmojnë në rindërtimin e historisë së sitit.
Kërkimet vijojnë edhe me dokumentimin, pastrimin dhe konservimin e zbulimeve, ndërsa në zona të tjera të kompleksit janë evidentuar edhe mozaikë pjesërisht të dëmtuar, që mendohet se i përkasin shekullit III.

Por historia e Qesaratit shkon shumë më tej se periudha Romake. Në kërkimet e mëparshme janë zbuluar mbi 1,100 vegla stralli, dëshmi e një vendbanimi prehistorik dhe e pranisë së hershme njerëzore në këtë territor.
Nga veglat e strallit te mozaikët romakë, nga gjurmët e banimit të hershëm te fragmentet e pikturave murale, nëntoka e Qesaratit vazhdon të zbulojë shtresë pas shtrese historinë e një peizazhi të banuar për mijëra vjet.








IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Trashëgimia arkeologjike shqiptare në finalen e “Palmyra Award”

Varri monumental i zbuluar në Strikçan të Bulqizës, në kuadër të një projekti të drejtuar nga Instituti i Arkeologjisë, është përzgjedhur mes pesë finalistëve për çmimin ndërkombëtar “Palmyra” dhe çmimin “Special” të publikut në Borsa Mediterranea del Turismo Archeologico (BMTA).
Mauzoleu i periudhës romake, që daton në shekujt III–IV, përfaqëson një zbulim të veçantë për arkeologjinë shqiptare dhe është i pari i këtij lloji i evidentuar në Shqipëri. Brenda tij janë zbuluar enë qelqi, objekte prej kocke dhe tekstile të endura me fije ari, duke ofruar të dhëna të reja mbi praktikat funerare dhe jetën në këtë territor gjatë periudhës romake.

Në finalen e “Palmyra Award”, zbulimi shqiptar prezantohet përkrah gjetjeve arkeologjike nga Pompeii, Vulci, Taposiris Magna dhe Herakleia e Latmos, duke sjellë në vëmendje një tjetër dëshmi të rëndësishme të pasurisë arkeologjike të Shqipërisë.





IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.